

Ftesë

Qendra Shqiptare për Konkurrueshmëri dhe Tregti Ndërkombëtare (ACIT), me mbështetjen e Fondacionit për Shoqërinë e Hapur (OSFA), ka kënaqësinë t'ju ftojë në tryezën:

“Integrimi ekonomik dhe tregtar midis Shqipërisë dhe Kosovës: Një platformë e përbashkët zhvillimi”

E enjte, 21 nëntor, 2019

Ora: 14.00 - 15:30

Vendi: Hotel Tirana International, Salla Bogdani

Qendra Shqiptare për Konkurrueshmërinë dhe Tregtinë Ndërkombëtare (ACIT), me mbështetjen e Fondacionit për Shoqërinë e Hapur në Shqipëri (OSFA), ka ndërmarrë një studim për të analizuar procesin e integritimit ekonomik dhe tregtar të Shqipërisë dhe Kosovës. Objektivi i këtij projekti është informimi dhe ndërgjegjësimi mbi rëndësinë dhe potencialet e zhvillimit të hapësirës së përbashkët ekonomike midis dy vendeve. Për këtë qëllim, ekspertët e angazhuar kanë realizuar monitorimin dhe analizën e zbatimit të marrëveshjeve dypalëshe, identifikimin dhe listimin e barrierave të ndryshme, si dhe analizën ekonometrike të potencialeve të pashfrytëzuara midis dy ekonomive.

Në kuadër të prezantimit dhe diskutimit të gjetjeve paraprahe nga ky studim, si dhe të marrjes së mendimeve të studiuesve dhe ekspertëve të pavarur, ju ftojmë në këtë aktivitet, sipas axhendës më poshtë.

Ju lutemi të konfirmoni pjesëmarrjen tuaj në adresën e-mail: info@acit.al

AXHENDA E AKTIVITETIT

13:45 - 14:00 Regjistrimi i pjesëmarrësve

14:00 - 14:10 Hapja e aktivitetit dhe fjalët përshëndetëse

Z. Gentian Elezi, drejtues i projektit, ACIT

14:10-14:45 Gjetjet dhe rekomandimet paraprahe mbi tregtinë Shqipëri-Kosovë

Z. Selami Xhepa,

Znj. Mimoza Agolli

14:45 - 15:30 Ndërhyrje dhe diskutim i hapur me studiues dhe ekspertë

Pyetje dhe konkluzionet e aktivitetit